



REPUBLIKA E SHqipëRIE
MINISTRIA E FINANCAVE
DHE EKONOMISE

JANAR 2021

EKONOMIA DHE BUXHETI

Raport Mujor

EKONOMIA DHE BUXHETI

Raport Mujor

Janar 2021

© Ministria e Financave dhe Ekonomisë, 2021
Drejtoria e Analizave Makroekonomike dhe Statistikave
Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Nr. 3, Tiranë

www.financa.gov.al

E-mail: Juli.Lubonja@financa.gov.al

Përmbajtja

VEÇORITË KRYESORE _____ **2**

ZHVILLIMET EKONOMIKE _____ **3**

1. Indeksi i Çmimeve të Konsumit _____ 3
2. Kursi mesatar i Këmbimit _____ 4
3. Ecuria e Normave të Interesit të Depozitave dhe Huave _____ 5
4. Bilanci i Pagesave _____ 6
5. Mjetet Valutore Neto të Sistemit Bankar _____ 7
6. Kredia për Ekonominë _____ 8
7. Oferta e Parasë _____ 9
8. Depozitat sipas burimeve _____ 10

SEKTORI FISKAL _____ **11**

1. Buxheti i Konsoliduar _____ 11
2. Të Ardhurat Sipas Burimeve _____ 12
3. Financimi i Bilancit Fiskal _____ 13

ANEKSI STATISTIKOR _____ **13**

Veçoritë Kryesore

- *Indeksi i çmimeve të konsumit në muajin Janar 2021, arriti në 101.3;*
- *Norma vjetore e inflacionit për muajin Janar 2021 ishte 0.4 përqind;*
- *Kursi mesatar i këmbimit të monedhës vendase me dy monedhat kryesore të huaja për muajin Janar 2021 ishte 101.61 lekë për dollarë dhe 123.53 lekë për euro;*
- *Normat e interesit të depozitave në lekë gjatë muajit Janar 2021 shënuan kuotën 0.47 përqind për ato 12-mujore; 0.29 përqind për depozitat 6-mujore; 0.15 përqind për depozitat 3-mujore dhe 0.40 përqind për depozitat 1-mujore;*
- *Normat e interesit për huatë në lekë ishin 6.85 përqind për huatë 12-mujore dhe 5.56 përqind për ato 6-mujore;*
- *Oferta totale e parasë, e matur nga agregati M3, arriti në rreth 1.456.814 milionë lekë në muajin Janar, duke shënuar një rritje prej rreth 10 përqind, krahasuar me një vit më parë;*
- *Bilanci i përgjithshëm i pagesave për tremujorin e katërt të 2020-ës rezultoi me rënie të mjeteve valutore (rezervës), duke shënuar vlerën -142.7 milionë euro.*
- *Situata Buxhetore për periudhën Janar 2021 rezultoi me një suficit të përgjithshëm prej rreth +2.01 miliardë lekë, ndërkohë që ishte planifikuar një deficit prej -1.66 miliardë lekë.*
- *Të ardhurat gjithsej të realizuara për periudhën Janar 2021, arritën në rreth 35.215 miliardë lekë ose afërsisht -1.1% më pak se plani për këtë periudhë.*
- *Shpenzimet gjithsej gjatë së njëjtës periudhë, arritën në rreth 33.208 miliardë lekë ose rreth -10.9% më pak se shpenzimet e planifikuara për këtë periudhë.*

Zhvillimet Ekonomike


1. Indeksi i Çmimeve të Konsumit

Inflacioni vjetor për muajin Janar 2021 ishte 0.4%. **Ndërkohë**, një vit më parë ndryshimi vjetor i indeksit të çmimeve të konsumit ishte 1.5%. Ndryshimi mujor i indeksit të çmimeve të konsumit në muajin Janar 2021, krahasuar me Dhjetor 2020 është 1.3%. Një muaj më parë, Dhjetor 2020, IÇK shënoi rritje mujore prej 0.3%.

Referuar një viti më parë, Indeksi i Çmimeve të Konsumit për muajin Janar 2020 shënoi rritje mujore prej 1.9%, në krahasim me muajin paraardhës.

Krahasuar me muajin Janar 2020, rritja më e madhe e çmimeve vërehet në grupin “Mobilje, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë” me 2%, pasuar nga grupet “Argëtim dhe kulturë me 1.7% dhe “Ushqime dhe pije joalkoolike” me 1.2%.

Nga tërësia e mallrave dhe shërbimeve që përbëjnë shportën e konsumit, çmimet e grupit “Transporti” u ulën me 4.7%, pasuar nga grupet “Veshje dhe këpucë” me 0.4% dhe “Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji” me 0.1%.



Ndryshimi mujor i indeksit është 1.3%. Krahasuar me muajin Dhjetor 2020, çmimet e grupit “Ushqime dhe pije joalkoolike” u rritën me 3%, pasuar nga grupet “Shëndeti” me 1%, “Pije alkoolike dhe duhan” me 0.8%, “Mobilje, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë” me 0.7%, “Argëtim dhe kulturë” dhe “Hotele, kafene dhe restorante” me 0.6% secili.

Nga ana tjetër çmimet e grupit “Transporti” dhe “Mallra dhe shërbime të ndryshme” u ulën me 0.2% secili. Ndërkohë, grupet “Veshje dhe këpucë”, “Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji” dhe “Shërbimi arsimor” u ulën me 0,1 % secili

Tab - 1 Ndryshimi vjetor i Indeksit të Çmimeve të Konsumit (në %)


VITI	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor
2020	1.5	1.2	2.1	1.9	2.1	1.8	1.4	1.3	1.5	2.0	1.6	1.1
2021	0.4	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-

Burimi: INSTAT

2. Kursi mesatar i këmbimit

Kursi mesatar i këmbimit të lekut kundrejt euros në muajin Janar 2021, arriti në 123.53 lekë/euro, duke shënuar rënie në vlerë me -0.01 përqind krahasuar me një muaj më parë. Në fund të muajit Janar, një euro u këmbye me 123.61 lekë.

Kursi mesatar i këmbimit të lekut kundrejt dollarit amerikan në muajin Janar 2021 arriti në 101.61 lekë/dollarë duke shënuar rritje në vlerë me +0.02 përqind kundrejt një muaji më parë. Në fund të muajit Janar, kursi i këmbimit për dollarin amerikan arriti në nivelin 101.97 lekë/dollarë.



Në krahasim me muajin Janar të vitit të kaluar, pas një periudhe të konsiderueshme forcimi, rezulton se monedha shqiptare ka pësuar një nënçmim ndaj monedhës europiane në masën 1.19 përqind, ndërsa kundrejt dollarit amerikan rezulton se është mbiçmuar në masën 7.68 përqind. Në pëgjithësi, dobësimi i lekut në vitin e fundit ka ardhur si pasojë e një rënie relative të ekonomisë në vend, për shkak të dy goditjeve të njëpasnjëshme, tërmetit të ndodhur në dhjetor 2019 dhe situatës së krijuar nga pandemia botërore Covid-19 (Mars 2020).

Kursi i këmbimit të euros me dollarin amerikan, shënoi një rritje mesatare rreth 0.82 dollarë/euro.

Ndër faktorët e brendshëm që kanë ndikuar në ecurinë e monedhës vendase gjatë kësaj periudhe përmendim: qendrueshmëria e kursit të këmbimit për shkak të ndërhyrjes së shpejtë të BSH-së, stabiliteti i situatës makroekonomike në vend, efikasiteti i politikës fiskale, efikasiteti në politikën monetare dhe në operacionet ndërbankare të ndërmarra nga BSH-ja, etj.

3. Ecuria e Normave të Interesit të Depozitave dhe Huave



Gjatë muajit Janar 2021, normat e interesit të depozitave me afat 12 dhe 1 muajore shënuan vlerat më të larta prej 0.47 dhe 0.41 përqind përkatësisht, pasuar nga ato me afat 6 dhe 3 muajore që arritën kuotën 0.32 dhe 0.15 përqind përkatësisht.

Krahasuar me një muaj më parë, normat e interesit të depozitave me afat maturimi 6 dhe 12 muajore kanë shënuar rënie mujore prej përkatësisht 0.02 dhe 0.07 pikë përqindje. Ndërsa normat e interesit të depozitave me afat 1 muajore shënuan rënie mujore prej 0.01, ndërkohë ato me afat 3 muaj nuk patën ndryshim.

Referuar një viti më parë, normat e interesit të depozitave me afat maturimi 1, 3 dhe 6 muajore kanë shënuar rënie vjetore prej përkatësisht 0.40, 0.25 dhe 0.16 pikë përqindje. Ndërsa normat e interesit të depozitave me afat 12 muajore shënuan rritje vjetore me 0.07 pikë përqindje.

Normat e Interesit të huave 6 dhe 12 muajore, gjatë muajit Janar 2021, arritën përkatësisht kuotën prej 5.56 dhe 6.85 përqind. Në krahasim me një muaj më parë, normat e interesit të huave 6 muajore kanë shënuar rënie me 0.92 pikë përqindje. Ndërkohë, ato 12 muajore kanë shënuar rritje prej 0.49 pikë përqindje. Krahasuar me një vit më parë normat e interesit të huave 6 muajore kanë shënuar rënie vjetore prej 1.31 pikë përqindje. Ndërsa ato 12 muajore kanë pësuar rritje prej 0.12 pikë përqindje.


Normat e interesit të bonove të thesarit 12 muajore për muajin Janar 2021 patën rritje mujore dhe vjetore përkatësisht me 0.15 pikë përqindje.



4. Bilanci i Pagesave

Në tremujorin e katërt të vitit 2020, bilanci i përgjithshëm i pagesave rezultoi negativ në rënie të mjeteve valutore (rezervës) prej rreth 143 milionë euro. Deficiti i llogarisë korrente vlerësohet në rreth 352 milionë euro, i zgjeruar në terma vjeto-rë me rreth 6 milionë euro (ose 2%). Thellimi i deficitit korrent, është diktuar nga zgjerimi i deficitit tregtar në mallra dhe bal-ancës negative të të ardhurave parësore. Kjo ecuri është kompensuar pjesërisht nga zgjerimi i suficitit në shërbime dhe rritja e balancës pozitive në të ardhurat dytësore. Për tremujorin e katërt 2020, shkalla e ekspozimit të ekonomisë shqiptare vlerësohet në 296 milionë euro, në rënie me 23 milionë euro referuar nivelit në një vit më parë. Flukset hyrëse në llogarinë kapitale dhe financiare (përfshirë mjetet e rezervës) shënojnë 239 milionë euro dhe mundësojnë mbulimin e deficitit korrent në masën 68%.

Fig-5




Bilanci i Pagesave T4 - 2020

Burimi: Banka e Shqipërisë

Në tremujorin e katërt 2020:

- Deficiti i llogarisë korrente vlerësohet në rreth 352 milionë euro, i thelluar në terma vjetorë;
- Llogaria e shërbimeve vlerësohet në një balancë pozitive prej rreth 303 milionë euro, me rritje në terma vjetorë;
- Fluksi i investimeve të huaja direkte, në formën e zgjerimit të kapitalit vlerësohet në 257 milionë euro;
- Të ardhurat në formën e prurjeve valutore nga emi-grantët shënuan 203 milionë euro;

Fig-6




Llogaria Korente T4 - 2020

Burimi: Banka e Shqipërisë


5. Mjetet Valutore Neto të Sistemit Bankar

Gjatë muajit Janar 2021, sistemi bankar ka shënuar rritje të mjeteve valutore neto (M.V.N), me rreth 57.657 milionë lekë krahasuar me muajin Janar të vitit 2020. Kjo rritje ka ardhur kryesisht si pasojë e rritjes së mjeteve valutore neto të bankës qendrore me 70.435 milionë lekë. Krahasuar me një muaj më parë mjetet valutore neto kanë shënuar rënie me -4.344 milionë lekë, ku më së shumti ka kontribuar rënia mujore prej -10.649 milionë lekë e Bankës Qëndrore.




Oferta totale e parasë, e matur nga agregati M3, arriti në rreth 1.456.814 milionë lekë në muajin Janar 2021, duke shënuar një rritje prej rreth 132.482 milionë lekë krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, pra një rritje vjetore prej 10 përqind.

Gjithashtu në muajin Janar 2021, sistemi bankar rezulton me rënie mujore prej 178 milionë lekë ose 0.01 përqind në mjetet valutore neto krahasuar me muajin paraardhës.




6. Kredia për Ekonominë

Totali i kredisë për ekonominë për muajin Janar 2021 arriti në rreth 606.283 milionë lekë. Bilanci i kredisë, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, shënoi rritje me vlerë 37.253 milionë lekë, ose rritje me rreth 6.5 përqind. Struktura e kredisë sipas monedhave është e balancuar mes monedhës kombëtare (53%) dhe monedhave të huaja (47%).




Gjatë muajit Janar 2021, zëri “Korporata të tjera jo-financiare”, zuri peshën më të lartë të totalit të kredisë, me rreth 60.7 përqind ose 368.132 milionë lekë, ndjekur nga kreditë për individë, ku pesha e tyre specifike arriti në nivelin 34.59 përqind ose rreth 209.741 milionë lekë. Zërat “Korporata jo financiare publike” dhe “Korporata të tjera financiare” arritën respektivisht 2.44 dhe 2.18 përqind apo 14.771 dhe 13.215 milionë lekë.




Për sa i përket shpërndarjes së kredisë sipas monedhës së huaj për muajin Janar 2021, zëri “Korporata të tjera jofinanciare” zuri peshën më të lartë të kredisë, me rreth 60.7 përqind, ndjekur nga “Sektorë të tjerë rezidentë” me rreth 34.59 përqind. “Korporata të tjera financiare” dhe “Korporata jofinanciare publike” kontribuojnë përkatësisht me 2.18 përqind dhe rreth 2.44 përqind.

7. Oferta e Parasë

Paraja jashtë Korporatave Depozituese arriti në rreth 342.887 milionë lekë në fund të muajit Janar 2021. Raporti i Parasë jashtë Bankave me M3 në Janar 2021 ka shënuar rënie mujore prej 0.11 përqind dhe rritje vjetore prej 1.9 përqind, duke arritur nivelin 23.5 përqind. Raporti i Parasë jashtë Bankave me Depozitat ka shënuar rënie mujore prej 0.19 përqind, dhe rritje vjetore prej 3.16 përqind, duke shënuar nivelin 30.8 përqind.




Depozitat në valutë, si përbërësi kryesor i ofertës monetare për muajin Janar 2021, kanë shënuar rritje vjetore prej 29.879 milionë lekë, e sjellë kryesisht nga depozitat për individë, të cilat kanë përbërë rreth 80.3 përqind të depozitave në valutë. Gjithashtu depozitat në Lekë gjatë muajit Janar 2021 shënuan rritje prej 46.323 milionë lekë në krahasim me muajin Janar 2020. Sektori i Individëve në lekë ka zënë rreth 80.6 përqind të tyre.



8. Depozitat sipas Burimeve


Gjatë muajit Janar 2021, zëri “Sektorë të tjerë rezidentë” zuri nivelin më të lartë të depozitave të transferueshme në lekë, me rreth 80.6 përqind, ndjekur nga “Korporata të tjera jofinanciare”, me rreth 14.3 përqind dhe nga “Korporata jo-financiare publike” me 3.1 përqind. “Sektorë të tjerë rezidentë” dhe “Korporata të tjera jofinanciare” ishin gjithashtu burimi më i rëndësishëm i depozitave në monedhë të huaj, përkatësisht me rreth 80.3 përqind dhe rreth 18.2 përqind. “Sektorë të tjerë rezidentë” ishin dukshëm burimi më i rëndësishëm i depozitave totale me rreth 80.5 përqind e totalit.



Rritja e stokut total të depozitave

Burimi: Banka e Shqipërisë

Në total, “Sektorë të tjerë rezidentë” përbëjnë pjesën më të madhe me rreth 889.339 milionë lekë të depozitave totale. Ata ndiqen nga “Korporata të tjera jofinanciare” (180.818 milionë lekë), “Korporata të tjera financiare” (15.179 milionë lekë), dhe “Korporata jofinanciare publike” (18.260 milionë lekë). “Qeveria lokale” kontribuoi me rreth (1.738 milionë lekë) në totalin e depozitave. Gjatë muajit Janar 2021, niveli i përgjithshëm i depozitave arriti vlerën rreth 1.105.335 milionë lekë.



Përberja e depozitave Janar '21

Burimi: Banka e Shqipërisë


Krahasuar me një muaj më parë niveli i depozitave shënoi rritje prej rreth 1.494 milionë lekë, gjithashtu krahasuar me një vit më parë totali i depozitave ka shënuar rritje me 76.202 milionë lekë.

Sektori Fiskal

1. Buxheti i Konsoliduar

Për periudhën Janar 2021 janë mbledhur rreth 35.215 miliardë lekë të ardhura, përkundrejt shpenzimeve të përgjithshme prej 33.208 miliardë lekë, ku pjesa më e madhe përfshin 31.127 miliardë lekë në shpenzime korrente dhe rreth 1.983 miliardë lekë në shpenzime kapitale, nga të cilat rreth 100% janë financime të huaja.

Nga të ardhurat gjithsej, pjesa e të ardhurave të mbledhura nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Doganave është rreth 23.093 miliardë lekë (ose rreth 2.8% më pak se plani i periudhës). Të ardhurat e mbledhura nga pushteti vendor janë rreth 1.344 miliardë lekë (ose rreth 4.9% më shumë se plani i periudhës). Kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore 9.470 miliardë lekë (ose rreth 1.4% më shumë se plani i periudhës) dhe të ardhurat jo-tatimore në nivelin 1.200 miliardë lekë (ose rreth 2.9% më pak se plani për periudhën Janar 2021).



Nga totali i shpenzimeve korrente prej 31.127 miliardë lekë, 6.421 miliardë lekë (20.6%

e totalit të shpenzimeve korrente) është shpenzuar për personelin, rreth 4.547 miliardë lekë (14.6%) për shpenzime interesi, 2.366 miliardë leke (7.6%) për shpenzime operative dhe mirëmbajtje, 88 miliardë lekë (0.3%) për subvencione, 13.738 miliardë lekë (44%) për shpenzimet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, 2.466 miliardë lekë (7.9%) për shpenzimet e qeverisjes vendore, dhe 1.503 miliardë lekë (4.8%) për shpenzimet e tjera. Shpenzimet kapitale u financuan plotësisht, 100% me financim të huaj.

2. Të ardhurat sipas burimeve

Të ardhurat gjithsej të realizuara për periudhën Janar 2021 ishin rreth 35.215 miliardë lekë, nga të cilat të ardhurat tatimore rreth 33.908 miliardë lekë, të ardhurat jo-tatimore në rreth 1.200 miliardë lekë.

Tab - 2	Të ardhurat gjatë muajit Janar 2021 (mld Lekë) Revenues during January 2021 (in billion ALL)			
	Burimi (Source)	Janar '21 January '21	Janar '20 January '20	Ndrysh(%) Chang (%)
	TVSH (VAT)	11.1	11.5	-2.5
	Taksa doganore (Custom Tax)	0.37	0.45	-16.8
	Akcizat (Excise)	3.19	3.4	-6.3
	Tatimi mbi fitimin (Profit Tax)	1.6	2.3	-31.2
	Tatim mbi të ardhurat personale (TAP) / (Income Tax)	3.4	3.5	-2.2
	Taksat nacionale (National Tax)	3.4	2.5	37

Burimi: Ministria e Financave, Statistikat Fiskale: Janar - 2021

Source: Ministry of Finance, Fiscal Statistics: Janar - 2021

3. Financimi i Bilancit Fiskal

Suficiti prej 2.01 miliardë lekë gjatë periudhës Janar 2021, u përdor kryesisht për shlyerjen e borxhit.

Vetëm për muajin Janar 2021, disa nga treguesit kryesorë fiskalë ishin:

- Realizimi i të ardhurave në masën 35.215 miliardë lekë,
- Realizimi i shpenzimeve në masën 33.208 miliardë lekë.

Në realizimin e të ardhurave për muajin Janar 2021, kontributin kryesor e kanë dhënë të ardhurat tatimore, të cilat arrijnë shifrën e 33.9 miliardë lekë. Në realizimin e shpenzimeve për këtë muaj, peshën me të lartë e zënë shpenzimet korrente me 31.1 miliardë lekë dhe shpenzimet për fonde speciale me rreth 13.7 miliardëlekë

Aneksi Statistikor

Tab - 1

Indeksi i çmimeve të konsumit

Consumer price index (in %)

Muaji	Mujor (Monthly)						Mesatar Mujor (Monthly Average)						Vjetor (Annual)					Month	
	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2016	2017	2018	2019	2020		2021
Janar	0.9	1.5	1.5	1.6	1.9	1.3	0.9	1.5	1.5	1.6	1.9	1.3	1.5	2.8	1.7	1.9	1.5	0.4	January
Shkurt	1.1	0.5	0.8	0.6	0.4		1.0	1.0	1.1	1.1	1.1		0.2	2.2	2.1	1.7	1.2		February
Mars	0.5	0.4	0.3	-0.3	0.6		0.8	0.8	0.9	0.6	0.9		0.3	2.1	2.0	1.1	2.1		March
Prill	-0.4	-0.6	-0.5	-0.2	-0.4		0.5	0.5	0.5	0.4	0.6		0.3	1.9	2.1	1.4	1.9		April
Maj	-1.2	-1.2	-1.2	-1.0	-0.8		0.2	0.1	0.2	0.1	0.3		0.7	2.0	2.1	1.5	2.1		May
Qershor	-0.6	-0.4	-0.1	-0.3	-0.6		0.04	0.0	0.1	0.1	0.2		1.2	2.2	2.4	1.3	1.8		June
Korrik	0.0	-0.1	-0.3	-0.1	-0.5		0.04	0.0	0.1	0.0	0.1		1.9	2.0	2.3	1.5	1.4		July
Gusht	0.9	0.4	0.4	0.3	0.2		0.14	0.1	0.1	0.1	0.1		2.0	1.6	2.2	1.5	1.3		August
Shtator	0.4	0.4	0.2	0.1	0.4		0.17	0.1	0.1	0.1	0.1		1.8	1.6	2.1	1.3	1.5		September
Tetor	-0.2	0.0	-0.2	-0.2	0.2		0.04	-0.1	-0.1	-0.1	0.1		1.8	1.6	2.1	1.3	2.0		October
Nëntor	0.1	-0.1	-0.2	-0.2	-0.5		0.12	0.1	0.1	0.0	0.1		1.9	1.7	1.8	1.4	1.6		November
Dhjetor	0.1	-0.1	-0.2	-0.2	0.3		0.05	-0.1	-0.1	-0.1	0.1		1.9	1.7	1.8	1.4	1.1		December

Burimi : INSTAT

Source : INSTAT

Tab - 2 Kursi i këmbimit
Exchange rate

Monedha	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021 Janar January	Currency
Mesatarja e periudhës								Average of period
USD	125.96	124.15	119.10	107.99	109.85	108.65	101.61	USD
EURO	139.74	137.36	134.15	127.59	123.01	123.77	123.53	EURO
Fundi i periudhës								In the end of period
USD	125.79	128.17	111.10	107.82	108.64	100.84	101.97	USD
EURO	137.28	135.23	132.95	123.42	121.77	123.70	123.61	EURO

Burimi : Banka e Shqipërisë

Source : Bank of Albania

Tab - 3 Normat e interesit me bazë vjetore (në Lek)
Annual Interest Rates (in ALL)

Në përqindje	2018	2019	2020	2021 Janar January	In percent
Norma e depozitave			Deposits rates		
12-M	0.73	0.49	0.41	0.47	12-M
6-M	0.59	0.42	0.35	0.32	6-M
3-M	0.28	0.23	0.21	0.15	3-M
1-M	0.76	0.66	0.49	0.41	1-M
Norma e huasë			Lending rates		
12-M	5.66	6.25	6.05	6.85	12-M
6-M	8.12	7.07	6.28	5.56	6-M
Norma e letrave me vlerë			Securities rates		
Bono thesari 1/					Treasury bills 1/
3-M	-	-	-	1.09	3-M
6-M	-	-	-	-	6-M
12-M	1.43	1.69	1.77	1.92	12-M

Burimi : Banka e Shqipërisë

Source : Bank of Albania

TREGUESIT FISKAL SIPAS BUXHETIT TË KONSOLIDUAR 2021

Fiscal indicators regarding consolidated budget of 2021

Të dhëna progresive (Progressive Data)

në milionë Lekë (in million ALL)

Nr.	E M È R T I M I	Janar January	ITEMS
	TOTALI TË ARDHURAVE	35,215	TOTAL REVENUE
I.	Të ardhura nga ndihmat	108	Grands
II.	Të ardhura tatimore	33,908	Tax Revenue
II.1	Nga Tatimet dhe Doganat	23,093	From tax offices and customs
1	Tatimi mbi Vlerën e Shtuar	11,205	V.A. T
2	Tatimi mbi Fitimin	1,553	Profit Tax
3	Akcizat	3,185	Excise Tax
4	Tatimi mbi të Ardhurat Personale	3,382	Personal Income Tax
5	Taksa Nacionale dhe të tjera	3,394	National Taxes and others
6	Taksa Doganore	375	Customs Duties
II.2	Të ardhura nga Pushteti Vendor	1,344	Revenues from Local Gov.
1	Taksë mbi Pasurinë (ndërtesat)	283	Property Tax
2	Taksë mbi Biznesin e vogël	2	Small Business Tax
3	Taksa Lokale	1,060	Local Taxes
II.3	Të ardh nga fondet speciale	9,470	Social ins. contributions
1	Sigurimi Shoqëror	8,127	Social Insurance
2	Sigurimi Shëndetsor	1,333	Health insurance
3	Të ardhura për kompensim në vlerë të pronarëve	11	Compensation income in the value of owners
III.	Të ardhura Jotatimore	1,200	Nontax Revenue
1	Tran.Fitimi nga Banka e Shqipërisë		Profit transfer from BOA
2	Të ardhura nga Inst.Buxhetore	748	Income of budgetary institutions
3	Tarifat shërbimeve	193	Utility fees
4	Të tjera	259	Others
	TOTALI I SHPENZIMEVE	33,208	TOTAL EXPENDITURE
I.	Shpenzime Korrente	31,127	Current Expenditures
I.1	Personell	6,421	Personnel expenditures
1	Paga	5,510	Wages
2	Kontributi për Sigurime Shoqërore	904	Social insurance contributions
3	Arsimi I larte nga te ardhurat e veta	6	Higher education from its own income
I.2	Interesat	4,547	Interest
1	Të Brendshme	3,509	Domestic
2	Të Huaja	1,038	Foreign
I.3	Shpenzime Operative Mirëmbajtje	2,366	Operational & Maintenance
I.4	Subveclonet	88	Subsidies
I.5	Shpenzime për fonde speciale	13,738	Social insurance outlays
1	Sigurime Shoqërore	10,493	Social insurance
2	Sigurime Shëndetsore	2,632	Health insurance
3	Fondi I kompensimit të pronarëve	613	Owners' Compensation Fund
I.6	Shpenzime per BuxhetIn Vendor	2,466	Local budget expenditure
I.7	Shpenzime të tjera	1,503	Other expenditures
1	Pagesa e Papunesisë	84	Unemployment insurance benefits
2	Ndihma Ekonomike	1,219	Economic Aid
3	Bonusi I lindjeve	200	Birth bonus
I.8	Transferime Kapitale		Capital transfers
II	Fondi Rezerve, Kontigjenca	92	Reserve fund/contingency
III	Shpenzime Kapitale	1,983	Capital expenditures
1	Financimi Brendshëm		Domestically financing
2	Financimi Huaj	1,983	Foreign financed
IV	Detyrimet e prapambetuara		Arrears
V.	DEFICITI	2,007	CASH BALANCE
V.1	FINANCIMI DEFICITIT	-2,007	CASH BALANCE FINANCING
V.2	Brendshëm	-2,780	Domestic
1	Të ardhura nga privatizimi	17	Privatization receipts
2	Hua-marrje e brendshme	7,460	Domestic new borrowing (net)
3	Të tjera	-10,257	Others
V.3	I huaj	773	Foreign
1	Hua afatgjatë(e marrë)	1,665	Long-term foreign borrowing (gross)
	Nga e cila nën-hua		Subsidiary Loan
2	Ndryshimi i gjendjes së arkës*	352	Chang. of stat. Account
3	Ripagesat	-1,245	Repayments
4	Mbështetje Buxhetore		Budgetary Support

Burimi : Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Source : Ministry of Finance and Economy

Tab - 5

Tabela e investimeve 2021

Table of investments 2021

Të dhëna progresive (Progressive Data)

në milionë Lekë (in million ALL)

Janar January		
Financim i brendshëm	- 2,780	Domestic financing
<i>Në %</i>	138.5	<i>In %</i>
Financim i huaj	773	Foreign financing
<i>Në %</i>	-38.5	<i>In %</i>
Totali	-2,007	Total
<i>Në %</i>	100	<i>In %</i>

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Source: Ministry of Finance and Economy

**Tab - 6 TË ARDHURAT DOGANORE 2021
CUSTOMS REVENUES 2021**

Të dhëna progresive (Progressive Data)

në milionë Lekë (in million ALL)

	Janar	
	January	
Taksë doganore	375	Customs Duties
TVSH	7,683	V.A.T
Akcizë	3,185	Excises
Të tjera (Renta Minerare)	247	Others (Mineral Rent)
TOTALI	11,491	Total

TË ARDHURAT TATIMORE 2020 (TAX REVENUE)

TVSH	3,522	V.A.T
Tatim mbi fitimin	1,553	Profit Tax
Tatimi mbi të ardhurat personale	3,382	Personal income tax
Taksa nacionale dhe të tjera	3,146	National taxes
TOTALI	11,602	Total
TOTALI I PËRGJITHSHËM	23,093	OVERALL TOTAL

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Source: Ministry of Finance and Economy

Tab - 7

DEFICITI DHE FINANCIMI PËR 2021

The Deficit and Its Financing for 2021

Të dhëna progresive (Progressive Data)

Në milionë lekë (In million ALL)

	Janar January	
TË ARDHURAT	35,215	REVENUE
SHPENZIMET	33,208	EXPENDITURES
BILANCI FISKAL	2,007	FISCAL BALANCE
FINANCIMI I BILANCIT FISKAL	-2,007	FINANCING
Financimi i brendshëm	-2,780	Domestic
a. Bono Thesari Neto		Treasury bills
b. Obligacione		Bonds
c. Ndryshimi i gjëndjes së arkës		Chang. of stat. account
Depozita e qeverisë në BSH		Deposit of Government in B.O.A
Depozita e ISSH dhe ISKSH		Deposit of Social & Health Ins.
d. Mjete në ruajtje		Non-budget revenues
e. Të ardhura nga privatizimi	17	Privatization receipts
f. Të tjera detyrime	-10,257	Others
g. Huamarrje Brendshme Vendori	7,460	Local Borrowing
Financimi i jashtëm	773	Foreign
a. Hua afatgjatë	1,665	Long-term foreign borrowing (gross)
b. Ndryshimi i gjëndjes së arkës	352	Chang. of stat. Account
c. Ripagesat	-1,245	Repayments
d. Mbeshtetje Buxhetore	0	Budgetary Support
Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë		Source: Ministry of Finance and Economy

BILANCI I PAGESAVE*Balance of payments**Në milion Euro**In millions Euro*

	Viti 2017	Viti 2018	Viti 2019	Q1_2020	Q2_2020	Q3_2020	
Llogaria korente	-865.90	-866.40	-1,088.70	-233.50	-378.70	-193.30	Current Account.
Bilanci tregtar	-2,824.10	-2,871.10	-3,143.80	-652.90	-655.60	-794.30	Trade Balance.
Eksporti I mallrave fob	797.10	986.10	906.50	199.60	170.80	189.30	Merchandise Exports. Fob
Importi I mallrave fob	-3,621.20	-3,857.20	-4,050.30	-852.50	-826.40	-983.60	Merchandise Imports. Fob
Bilanci i shërbimeve	1,081.90	1,111.00	1,263.90	268.80	138.70	346.90	Services Balance.
Shërbimet Kredi	2,856.20	3,072.80	3,404.60	647.90	317.60	664.20	Services Credit
Shërbimet Debi	1,774.30	1,961.80	2,140.70	379.10	178.90	317.30	Services Debt
Bilanci i të ardhurave	28.60	-13.80	-180.10	-53.60	-63.50	-30.40	Balance of Incomes
Të ardhurat Kredi	407.40	392.80	420.20	73.90	77.20	96.40	Income Credit
Të ardhurat Debi	-378.80	-406.60	-600.30	-127.50	-140.70	-126.80	Income Debt
Bilanci i transfertave	847.70	907.50	971.30	204.20	201.70	284.50	Balance of Transfers
Transferta private	961.80	1,005.40	1,105.50	244.10	241.90	331.90	Private Unrequired Transfers
Transfertat shtetërore	-114.10	-97.90	-134.20	-39.90	-40.20	-47.40	Official Unrequired Transfers
Llogaria kapitale	122.30	104.00	76.10	25.40	26.10	36.80	Capital Account
Llogaria financiare	-1,115.30	-1,142.60	-827.00	-215.20	-1,132.90	-92.50	Financial Account
Investime direkte	-993.80	-1,022.20	-1,036.30	-220.40	-223.30	-218.10	Direct Investment
Investime portofoli	-100.00	-76.10	140.60	20.10	-260.50	10.60	Portfolio Investment
Kapitale të tjera	49.00	-50.40	50.90	-19.80	-482.20	104.60	Other Capital
Gabime dhe harresa neto	-186.30	-8.70	107.90	-58.10	67.70	64.40	Net errors and omissions
Bilanci i përgjithshëm	185.40	371.50	-77.70	-51.00	848.00	0.40	Overall Balance
Rezervat	185.40	371.50	-77.70	-51.10	848.20	0.30	Reserve Assets
Përdor kred & huash nga FMN	70.50	-6.10	-17.80	-4.90	166.90	-10.40	Use of Fund Credit and Loans

*Burimi : Banka e Shqipërisë**Source : Bank of Albania*

MJETET VALUTORE NETO

Net Foreign Assets

Në milionë Lekë	2018	2019	2020	2021	Millions of Lek
Fundi i periudhes				Janar January	End of Period
Mjete valutore neto	724,363	733,114	803,487	799,143	Net foreign assets
Pretendime ndaj jorezidentëve	786,907	794,006	860,750	857,054	Claims on nonresidents
Minus Detyrime të jorezidentëve	62,544	60,892	57,263	57,910	Minus: Liabilities to nonresidents
Mjetet e brendshme	874,968	950,426	1,047,835	1,048,249	Domestic assets
Pretendimet neto ndaj qeverisë qendrore	340,781	378,524	435,613	438,525	Net claims on central government
Pretendime ndaj sektoreve te tjere	534,187	571,902	612,221	609,725	Claims on other sectors
Detyrimet e parasë së gjërë	1,264,127	1,318,662	1,456,993	1,456,814	Broad Money liabilities
Paraja jashtë Korporatave Depozituese	275,285	291,409	344,560	342,887	Money outside depository corporations
Depozita të transferueshme	375,047	408,780	490,394	491,196	Transferable deposits
Depozita të tjera	613,795	618,473	622,039	622,731	Other deposits
Depozita të përfshira në paranë e gjërë	148,927	178,375	186,892	188,628	Deposits excluded from Broad Money
Qeveria lokale dhe administrata publike					Local government and public administration
Korporata të tjera financiare	2,092	3,879	4,666	4,976	Other financial corporations
Korporata jofinanciare publike	376	336	252	249	Public nonfinancial corporations
Korporata të tjera jofinanciare	7,399	8,238	6,925	7,145	Other nonfinancial corporations
Sektorë të tjerë rezidentë	139,061	165,922	175,050	176,257	Other resident sectors
Letrat me vlerë të ndryshme nga aksionet	6,183	6,656	5,926	5,087	Securities other than shares
Korporata të tjera jofinanciare	164	101	57	56	Korporata të tjera jofinanciare
Sektorë të tjerë rezidentë	6,019	6,555	5,869	5,031	Other resident sectors
Huatë	2,838	2,527	3,757	4,411	Loans
Qeveria lokale dhe administrata publike					Local government and public administration
Korporata të tjera financiare	2,838	2,527	3,757	4,411	Other financial corporations
Korporata jofinanciare publike					Public nonfinancial corporations
Korporata të tjera jofinanciare					Other nonfinancial corporations
Sektorë të tjerë rezidentë					other resident sectors
Llogari të pagueshme	285	229	62	59	Accounts payable
Korporata të tjera Financiare					Other financial corporations
Korporata jofinanciare publike					Public nonfinancial corporations
Korporata të tjera jofinanciare	1	1	5	5	Other nonfinancial corporations
Sektorë të tjerë rezidentë	284	229	57	54	other resident sectors
Aksione dhe instrumenta të tjerë të kapitalit	188,868	200,257	214,394	213,119	Shares and other equity
Nga të cilat rezerva rivlerësimi	-6,266	-2,652	-1,095	-1,410	Of which: Valuation adjustment
Të tjera neto	-12,300	-23,895	-17,621	-21,084	Other items net
Detyrime të tjera	61,547	50,220	55,892	52,975	Other liabilities
Minus: Mjete të tjera	73,847	74,115	73,514	74,059	Minus: Other assets
Axhustimi i konsolidimit	403	729	919.0	358.0	Consolidation adjustment

Burimi : Banka e Shqipërisë

Source : Bank of Albania

Tab - 10 **KREDIA PËR EKONOMINË**
Credit to Economy

Në milion Lekë Fundi i periudhës	2018	2019	2020	2021 Janar January	Million of Lek End of Period
Totali i kredisë	532,818.6	570,792.2	608,779.8	606,283.2	Total Credit
Kredia për qeverinë lokale dhe administratën	682.6	560.6	429.1	419.5	Credits to local Government
Në lekë	682.6	560.6	429.1	419.5	in Lek
Në valutë	-	-	-	-	in Foreign Currency
Kredia për korporatat jofinanciare publike	20,270.0	24,182.4	15,150.8	14,776.8	Credits to Public Non-financial Corporations
Në lekë	16,594.1	18,489.7	11,819.6	12,165.0	in Lek
Në valutë	3,675.9	5,692.7	3,331.2	2,611.8	in Foreign Currency
Kredia për korporatat e tjera jofinanciare	317,578.4	335,884.5	370,356.3	368,131.8	Credits to other Non-financial Corporations
Në lekë	127,739.6	141,240.5	161,975.3	162,044.6	in Lek
Në valutë	189,838.8	194,644.1	208,381.0	206,087.1	in Foreign Currency
Kredia për korporatat e tjera financiare	10,164.0	13,555.1	13,169.1	13,214.5	Credits to Other Financial Corporations
Në lekë	4,802.1	8,023.8	7,489.2	7,355.7	in Lek
Në valutë	5,361.9	5,531.3	5,679.9	5,858.8	in Foreign Currency
Kredia për sektorë të tjerë rezidentë	184,123.6	196,609.5	209,674.5	209,740.6	Credits to other resident sectors
Në lekë	118,934.6	130,409.2	138,986.4	139,360.8	in Lek
Në valutë	65,189.0	66,200.3	70,688.1	70,379.8	in Foreign Currency

Burimi : Banka e Shqipërisë

Source : Bank of Albania

Tab - 11 **OFERTA E PARASË**
Money Supply

Mujor-Monthly

Në milion Lekë	2018	2019	2020	2021	
Fundi i periudhës				Janar	Millions of LEK
				January	End of Period
Baza monetare	423,428	433,951	534,347	519,607	Monetary base
Paraja jashtë korporatave depozituese	275,285	291,409	344,560	342,887	Currency outside depository corporations
Agregati M1	478,721	523,968	637,317	635,405	M1 Aggregate
Agregati M2	731,502	758,022	862,338	859,170	M2 Aggregate

Burimi : Banka e Shqiperisë

Source : Bank of Albania

DEPOZITAT

Deposits

Mujor-Monthly

Në milionë Lekë Fundi i periudhës	2018	2019	2020	2021 Janar January	Millions of Leks End of Period
Totali i depozitave	988,842	1,027,253	1,112,433	1,113,928	Total of deposits
Në lekë	456,217	466,613	517,778	516,283	In national currency
Depozitat e transferueshme	169,425	190,538	241,316	239,600	Transferable deposits
Qeveria lokale dhe administrata publike	1,482	1,624	1,644	1,630	Local governments and public administration
Korporata jofinanciare publike	8,662	10,667	13,747	15,053	Public nonfinancial corporations
Korporata të tjera financiare	2,570	3,694	3,666	3,986	Other financial corporations
Korporata të tjera jofinanciare	47,156	49,099	66,074	62,843	Other nonfinancial corporations
Sektorë të tjerë rezidentë	109,555	125,454	156,185	156,087	Other resident sectors
Depozita me likuiditet të lartë (Depozita pa afat)	34,012	42,021	51,442	52,919	Liquid deposits (Sight deposits)
Qeveria lokale dhe administrata publike					Local governments and public administration
Korporata jofinanciare publike	199	120	166	126	Public nonfinancial corporations
Korporata të tjera financiare	16	87	131	122	Other financial corporations
Korporata të tjera jofinanciare	2,066	2,873	3,970	4,475	Other nonfinancial corporations
Sektorë të tjerë rezidentë	31,730	38,942	47,175	48,196	Other resident sectors
Depozita të tjera	252,781	234,053	225,021	223,765	Other deposits
Qeveria lokale dhe administrata publike	13	10	10	10	Local governments and public administration
Korporata jofinanciare publike	1,635	709	1,465	900	Public nonfinancial corporations
Korporata të tjera financiare	5,051	4,147	4,868	4,535	Other financial corporations
Korporata të tjera jofinanciare	9,687	7,978	6,836	6,502	Other nonfinancial corporations
Sektorë të tjerë rezidentë	236,395	221,210	211,841	211,818	Other resident sectors
Në valutë	532,625	560,640	594,655	597,644	In foreign currency
Depozitat e transferueshme	205,623	218,241	249,078	251,597	Transferable deposits
Qeveria lokale dhe administrata publike	113	158	82	73	Local governments and public administration
Korporata jofinanciare publike	1,355	2,688	2,246	2,052	Public nonfinancial corporations
Korporata të tjera financiare	3,616	5,360	6,742	6,535	Other financial corporations
Korporata të tjera jofinanciare	75,861	79,001	90,281	91,058	Other nonfinancial corporations
Sektorë të tjerë rezidentë	124,676	131,036	149,726	151,878	Other resident sectors
Depozita me likuiditet të lartë (Depozita pa afat)	83,610	106,417	120,699	121,584	Liquid deposits (Sight deposits)
Qeveria lokale dhe administrata publike					Local governments and public administration
Korporata jofinanciare publike	53	136	97	130	Public nonfinancial corporations
Korporata të tjera financiare	0	1	1	0	Other financial corporations
Korporata të tjera jofinanciare	2,194	2,786	5,845	5,222	Other nonfinancial corporations
Sektorë të tjerë rezidentë	81,363	103,495	114,755	116,232	Other resident sectors
Depozita të tjera	243,393	235,982	224,878	224,464	Other deposits
Qeveria lokale dhe administrata publike				25	Local governments and public administration
Korporata jofinanciare publike	1,696	1,522	1,732	1,846	Public nonfinancial corporations
Korporata të tjera financiare	3,598	7,058	6,939	6,746	Other financial corporations
Korporata të tjera jofinanciare	11,814	11,662	10,854	10,718	Other nonfinancial corporations
Sektorë të tjerë rezidentë	226,284	215,741	205,353	205,128	Other resident sectors

Burimi : Banka e Shqipërisë

Source : Bank of Albania

Tab - 13 Tregues të shëndetit financiar (FSI)
(në përqindje)

Financial Soundness Indicators (FSI)

Përshkrimi i treguesit	Jan 2020	Shk 2020	Mar 2020	Pri 2020	Maj 2020	Qer 2020	Korr 2020	Gsh 2020	Sht 2020	Tet 2020	Nën 2020	Dh 2020	Jan 2021	Indeks description (in percentage)
Tregues me bazë kapitalin														
Kapitali rregullator ndaj aktiveve të ponderuara me rezik (në %)	-	-	19.08	-	-	18.10	-	-	18.64	-	-	18.32	-	Regulatory capital as a percent of risk-weighted assets (in %)
Kapitali rregullator (mln lekë)	-	-	158,700.58	-	-	151,803.11	-	-	153,807.62	-	-	152,550.65	-	Regulatory capital (million lek)
Aktive të ponderuara me rezik (mln lekë)	-	-	831,981.62	-	-	838,922.62	-	-	825,308.15	-	-	832,628.31	-	Risk-weighted assets
Kapitali rregullator i nivelit I ndaj aktiveve të ponderuara me rezik (në %)	-	-	17.92	-	-	17.02	-	-	17.48	-	-	17.23	-	Regulatory Tier 1 capital as a percent of risk-weighted assets (in %)
Kapitali ndaj totalit të aktiveve	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	Capital as a percent of total assets
Kapitali rregullator i nivelit I ndaj totalit të aktiveve	9.06	9.00	9.63	9.31	9.39	9.34	9.12	9.27	9.29	9.27	9.22	9.07	8.91	Regulatory Tier 1 capital as a percent of total assets
Kapitali rregullator ndaj totalit të aktiveve (në %)	9.69	9.61	10.25	9.91	10.00	9.93	9.70	9.89	9.91	9.88	9.82	9.65	9.48	Regulatory capital as a percent of total assets (in %)
Kapitali aksioner ndaj totalit të aktiveve (në %)	10.51	10.51	10.44	10.21	10.27	10.31	10.27	10.27	10.27	10.36	10.42	10.39	10.34	Shareholders' equity as a percent of total assets (in %)
Huatë me probleme neto nga provizionet ndaj kapitalit (në %)	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	Nonperforming loans net of provisions as a percent of capital (in %)
Huatë me probleme neto nga provizionet ndaj kapitalit rregullator të nivelit I (në %)	13.25	12.84	11.99	12.21	11.61	11.64	11.73	11.67	11.79	11.65	11.32	12.00	11.28	Nonperforming loans net of provisions as a percent of regulatory Tier1 capital (in %)
Huatë me probleme neto nga provizionet ndaj kapitalit rregullator (në %)	12.38	12.01	11.27	11.46	10.90	10.95	11.03	10.93	11.06	10.93	10.63	11.28	10.61	Nonperforming loans net of provisions as a percent of regulatory capital (in %)
Huatë me probleme neto nga provizionet ndaj kapitalit aksioner (në %)	11.41	10.99	11.06	11.13	10.61	10.54	10.42	10.53	10.67	10.42	10.02	10.47	9.72	Nonperforming loans net of provisions as a percent of shareholders' equity (in %)
Kthimi nga kapitali (ROE) (bazë vjetore) (në %)	9.96	9.54	3.52	5.28	7.78	9.12	9.39	9.92	9.12	9.62	9.91	10.65	11.64	Return on equity (ROE) (annual basis) (in %)
Pozicioni i hapur neto ne valutë ndaj kapitalit (në %)	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	Net open position in foreign exchange as a percent of capital (in %)
Pozicioni i hapur neto ne valutë ndaj kapitalit rregullator të nivelit I (në %)	6.27	7.08	7.79	7.60	7.32	5.73	6.29	7.09	7.76	7.81	8.76	8.97	7.44	Net open position in foreign exchange as a percent of regulatory Tier 1 capital (in %)
Pozicioni i hapur neto ne valutë ndaj kapitalit rregullator (në %)	5.86	6.62	7.32	7.14	6.87	5.39	5.91	6.64	7.28	7.33	8.22	8.44	7.00	Net open position in foreign exchange as a percent of regulatory capital (in %)
Pozicioni i hapur neto ne valutë ndaj kapitalit aksioner (në %)	5.40	6.06	7.19	6.93	6.69	5.19	5.58	6.40	7.02	6.99	7.75	7.83	6.41	Net open position in foreign exchange as a percent of shareholders' capital (in %)
Tregues me bazë aktivitet														
Aktive likuide ndaj totalit të aktiveve (metoda e gjërë)	35.60	35.38	35.36	34.93	34.23	33.27	33.02	33.35	33.99	34.62	35.46	34.81	34.92	Liquid assets as a percent of total assets (broad measure)
Aktive likuide ndaj totalit të aktiveve (metoda bazë)	15.20	14.87	15.42	14.38	13.08	12.04	12.14	12.43	13.13	13.25	14.66	13.56	13.42	Liquid assets as a percent of total assets (core measure)
Aktive likuide ndaj detyrimeve afatshkurtra (deri në një vit) (metoda e gjërë)	49.11	48.73	49.71	49.00	46.99	46.10	45.83	46.05	46.68	47.57	47.41	47.39	47.45	Liquid assets as a percent of short-term liabilities (broad measure)
Aktive likuide ndaj detyrimeve afatshkurtra (deri në një vit) (metoda bazë)	20.97	20.48	21.68	20.17	17.96	16.68	16.85	17.17	18.03	18.20	19.60	18.46	18.24	Liquid assets as a percent of short-term liabilities (core measure)
Kthimi nga aktivitet (ROA) (bazë vjetore) (fitimi neto para taksave)	1.16	1.13	0.44	0.62	0.88	1.03	1.05	1.27	0.97	1.09	1.11	1.20	1.37	Return on assets (ROA) (annual basis) (net profit before taxes)
Huatë me probleme (bruto) ndaj totalit të huave (në %)	8.30	8.18	8.21	8.28	8.14	8.09	8.12	8.13	8.30	8.29	8.20	8.11	8.20	Nonperforming loans (gross) as a percent of total loans (in %)
Tregues të të ardhurave dhe shpenzimeve														
Marzhi i interesave ndaj të ardhurave bruto	72.90	74.68	83.38	81.94	79.24	77.05	76.59	76.57	76.50	76.09	75.73	74.09	72.38	Interest margin to gross income
Shpenzime jointerese ndaj të ardhurave bruto	55.10	58.62	65.73	65.54	63.36	61.14	60.39	59.88	60.48	59.89	59.31	58.73	52.50	Noninterest expenses to gross income
Të tjera														
Numri i bankave	12.00	12.00	12.00	12.00	12.00	12.00	12.00	12.00	12.00	12.00	12.00	12.00	12.00	Number of banks

Burimi : Banka e Shqipërisë

Source : Bank of Albania